

Fillimi > -Kronikë

Udhëtonte me motor nga Tirana drejt Shkodrës, me automatik me silenciator, arrestohet vrasësi me pagesë. Policia: Dyshohet se do kryente një krim

05 Korrik, 2020 10:58 |



Madhësia e tekstit: - +

Një 48-vjeçar ka rënë në prangat e policisë, pasi u kap duke qarkulluar me një motomjet pa targa dhe me armë me vete. Bëhet fjalë për shtetasin me inicialet Gentian Bajramaj, 48 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për mashtrim dhe dhunë në familje. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ky shtetas është përdorur nga grupe kriminale për vrasje me pagesë. Ai u kap duke qarkulluar nga Tirana në drejtim të qarkut Shkodër.

Policia i sekuestron një armë zjarri automatik “Scorpion” me silenciator dhe 20 fishekë, me të cilën dyshohet se do kryente një vrasje.



“Shërbimet e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, pas informacioneve të marra në rrugë operative për një shtetas që qarkullonte me një motomjet pa targa i cili kishte armë me vete dhe dyshohej se mund të kryente një vrasje të porositur, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Mision i pamundur”. Falë ndërhyrjes në kohë, në fshatin Guri i Zi, forcat e Policisë të DVP Shkodër, në bashkëpunim me forcat “Shqiponja”, kanë bërë të mundur kapjen e shtetasit Gentian Bajramaj, 48 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për mashtrim dhe dhunë në familje. Në momentin e kapjes, këtij shtetasi, në një çantë krahu që mbante me vete i është gjetur një armë zjarri automatik “Scorpion” me silenciator dhe 20 fishekë luftarak. Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar arma e zjarrit dhe motomjeti pa targa. Nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër vijon puna për zbardhjen e arsyes së qarkullimit me armë zjarri me silenciator dhe motomjet pa targa. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për veprën penale “Armëmbajtja pa leje”.,- thuhet në njoftimin e policisë.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: arrestohet vrasesi

TË NGJASHME


- 

Dhunoi fizikisht dhe psikologjikisht nënën, arrestohet në flagrancë 25 vjeçari në Berat
25 Qershor, 2020
- 

Ron Jeremy arrestohet për përdhunim, ylli i pornos rrezikon deri në 90 vite burg
24 Qershor, 2020

Shfaq Komentet (0)


TË FUNDIT NGA -KRONIKË


- 

Aksidenti i rëndë në Fier, makina përplas për vdekje, pranë derës së shtëpisë një 64-vjeçar
05 Korrik, 2020
- 

E rëndë në Prato të Italisë, 52-vjeçari shqiptar gjendet i varur në një pemë
05 Korrik, 2020
- 

Vetëflijimi në Tiranë, vëllai i Zhaneta Josifit: Takimi i fundit me mbesën para 2 vitesh, ç'më thoshin kur iu shkoja në shtëpi
05 Korrik, 2020
- 


Të fshehura brenda një çante femrash, sekuestrohen mbi 77 mijë franga zviceriane në Morinë, pranga 2 poseduesve (Emrat)
05 Korrik, 2020
- 


"Një kufomë e kthyer në mumje, një dhomë e kyçur, pa drita e internet", eksperti tregon tmerrin brenda banesës ku u vetëflijua nënë e bijë
05 Korrik, 2020
- 

"Perëndia mund t'i rikthejë në jetë të vdekurit", zbulohet sekt i rekrutoi familjen Josifi në Kombin, hynin në banesën e tyre për...
05 Korrik, 2020

KATEGORIA VIDEO

- 

Vetëflijimi në Tiranë, vëllai i Zhaneta Josifit: Takimi i fundit me mbesën para 2 vitesh, ç'më thoshin kur iu shkoja në shtëpi
05 Korrik, 2020
- 

"Kapriçot" e motit/ Rrebeshe shiu dhe stuhitë në pak orë, përmbytet qyteti i Beratit (VIDEO)
Eneida Petova | 05 Korrik, 2020
- 

(Video) A respektohen masat kundër COVID-19? Task-Forcë zbrat në terren, kontrole në biznese: Kush thyen rregullat, gjohet e mbyllje aktiviteti
05 Korrik, 2020
- 

Përmbytjet "pushtojnë" Japoninë, shkon në 18 numri i të vdekurve, dhjetëra të zhdukur
05 Korrik, 2020
- 

Sipërfaqja me shkurre në Portëz të Fierit përfshihet nga flakët, digjet një makinë, rrezikohen disa shtëpi
05 Korrik, 2020
- 

VIDEO/ Kaloj gjysmën e jetës në burg dhe sot jeton me bonus qiraje, historia e pazakontë e rojës së shkolliës që OFL i kërkoi deklarimin e pasurisë
Dorjana Bezat | 05 Korrik, 2020

FAQET ZYRTARE

News24
Gazeta Shqiptare
Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert
Emisioni Chic
Emisioni Diplomaticus
Emisioni Vila 24
Kjo Javë
Klinika 24
Koha për t'u zgjuar
Me zemër të hapur
Monitor Ekonomi
Real Story
Shqiptarët për shqiptarët
Sport News
Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi
Shqipëria
Kosova
Rajoni
Sport
Bota
Kulturë
Metropol
Analiza
Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times
Guardian
WEB BBC
WEB CNN
REUTERS
Washington Post
Times Online
Financial Times
WEB Yahoo
WEB MSN
USA Today

